Policia shkatërron një laborator të drogës në Leposaviq, një person arrestohet dhe një në kërkim

LAJME

07/05/2024 21:04

Policia e Kosovës, konkretisht Njësia e antidrogës (DHTN) Mitrovicë veri pas një pune hetimore dhe sigurimit të informatave të besueshme nga tereni se disa persona të dyshuar kanë improvizuar një laborator për kultivimin e bimëve të dyshuara të kanabisit, sot me datën 07.05.2024, nën asistimin e zyrtarëve policor nga Drejtoria rajonale e Policisë (DRP) Mitrovicë veri dhe patrullave të Stacionit Policor në Leposaviq kanë realizuar një operacion të suksesshëm bastisje dhe kontrolli në fshatin Miokovicë të Leposaviqit, Mitrovicë veri.

Bastisja është kryer në një shtëpi banimi të të dyshuarit me iniciale (M.I.) dhe objektet përcjellëse, ku në një objekt përcjellës banimi në një dhomë është gjetur një laborator i improvizuar për kultivimin e bimëve të dyshuara të kanabisit.

Operacioni policor ka rezultuar me gjetjen e gjithsej (409) bimëve të dyshuara të kanabisit me gjatësi prej 5 deri në 15 cm, një pushkë gjuetie me gjithsej (43) fishek të gjuetisë, si dhe pajisje tjera të cilat nevojiten për improvizimin e laboratorit (poqa, ventilim, termostate, nxehëse, etj.), si dhe një jakne e Policisë së Kosovës.

Njësia e forenzikës ka bërë fotografimin dhe sekuestrimin e dëshmive.

Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori nga departamenti i krimeve të rënda dhe me udhëzim të tij, nga bimët merren disa mostra që do të dërgohen në laborator, kurse pjesa tjetër me urdhër të prokurorit shkatërrohen.

I dyshuari me inicialet (M.I.) me aktvendim të prokurorit kujdestar ndalohet për 48 orë, kurse i dyshuari tjetër me iniciale (S.S) është në kërkim të Policisë.

Rasti vazhdon të hetohet nga antidroga e (DHTN) Mitrovicë veri.



Më shumë nga uebi

nativeGRAM by LuponMedia

Duhet të fiini me derën e dhomës së gjumit mbyllur

Pas kufizimit të alkoolit, Gani Gërmia pin alkool

Best Workers Compensation Insurance in the USA


U tha Liridona u vra për të marrë 20 milionë euro nga

Gjëegjëza për fëmijë, por që as të rriturit nuk i zgjidhin

LAJME TË FUNDIT

Aksident mes një veture dhe një motoçiklete në...

Freedom House shpallet "organizatë e padëshirueshme" nga Rusia

Egla e ashpër me Meritonin: Ta kam përcjellë...

Policia e Kosovës ushtrohet nga EULEX për menaxhimin e krizave

Artikuj të ngjashëm



May 7, 2024
Aksident mes një veture dhe një motoçiklete në Prishtinë, lëndohen dy...

May 7, 2024
Freedom House shpallet "organizatë e padëshirueshme" nga Rusia

May 7, 2024
Policia e Kosovës ushtrohet nga EULEX për menaxhimin e krizave


May 7, 2024
DCPTG, platforma e cila dyshohet se u mashtruan me të madhe...

May 7, 2024
Pas Danimarkës edhe Austria synon marrëveshje që të burgosurit të vuajnë...

May 7, 2024
Klinika e Neonatologjisë për herë të parë pajiset me Autoambulancë Neonatale...

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy